



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.43, datë 29.04.2020

**“PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË,
TË DISA PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE QË DO TË PËRDOREN PËR
USHTRIMIN E DETYRAVE TË SAJ FUNKSIONALE NË REALIZIMIN E PROGRAMEVE
ARSIMORE”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.2, nenit 23, pika 11, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, nenit 3, shkronja “b” të Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, nenit 28, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pikës 6 dhe pikës 14, paragrafi i dytë i vendimit nr. 500, datë 14.08.2001, të Këshillit të Ministrave “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, pikës 1, shkronja “a”, të Udhëzimit nr.15, datë 30.06.2003, të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të disa pronave të paluajtshme shtetërore që do të përdoren për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në realizimin e programeve arsimore sipas formularëve bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015,“Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

TONI GOGU


